

Analizë e ngjarjeve të zhvilluara në Greqi gjatë vitit 1999.

*Nga Zaho Balili
29 mars – 30 korrik 1999*

Duke nisur të shkruaj këto radhë nuk kam ndërmend që të analizoj shkaqet ekonomiko - shoqërore të fundviteve '80, që i detyruan shqiptarët të marrin rrugët e kurbeteve, jo vetëm se nuk jam historian, por sepse nuk do të sillja ndonjë gjë të re për lexuesin dhe opinionin e gjerë shoqëror si brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Ato kohë të vështira të cilat pak a shumë janë të pranishme dhe sot në fundvitet '90, hapën një epokë të re në historinë e vendit tonë.

Shumëkush në fillim e quajti këtë rrugë të thjeshtë që vetëm me rrëzimin e ndonjë busti, prishjen e një sistemi, djegien dhe vjedhjen e asaj që quhej pasuri e popullit, hapjen e kufijve dhe çuarjen e gjithçkaje në nivelin zero, siç u shpreh atëherë një intelektual me emër, kapitalizmi ishte i ndërtuar dhe shqiptarët do të gdhieshin si në përralla miliarderë a milionerë, bota do të hapte thesin e të mirave për këtë popull që kishte vuajtur 50 vjet në diktaturën komuniste, dhe: lërna, o zot të rrojmë!!

Nuk do të kalonin shumë kohë dhe vetë ata do ta kuptonin që rruga e re ishte shumë e vështirë, sa përveç deteve të lotëve, lumenjve të gjakut, maleve të dhimbjeve, thikëve të plagëve do të sillte me vete dhe një fenomen të ri të panjohur dhe të padurueshëm për kombin tonë, përçmimin.

Kjo kuçedër e vrarë, e djegur dhe e harruar nga popujt e mbarë botës do të ringjallej si fantazmë ogurzezë pikërisht kur mbi glob po trokiste i lodhur, bastuni i shekullit të plakur dhe gjikush po nxitonte si në një fundviti me afrimi e krishtilindjeve, të rregullonte ç' nuk kishte bërë mirë. Dhe do të shfaqej pikërisht mbi Ballkanin e lashtë, herë – herë e veshur me rrobat karakteristike të shrigës e herë – herë moderniste me xhinset e grisura në gjunjë. Dhe do të hapte plagë të rënda dhe të hidhura sa vetëm në shqiptarët dimë ti durojmë për të mbetur përjetësisht lastarë të një rrënie shekullore.

Nuk dua që të bëj analizën e marrëdhënieve tona me Greqinë në këtë dhjetvjeçarim e fundit sepse ato asnjëherë nuk kanë qënë të qëndrueshme, përkundrazi janë luhatur nga ekstremi në ekstrem edhe për shkaqe shumë qesharake ose siç e themi ne: Për mustaqe të Çelos.

E vetmja pikë lidhëse e vazhdueshme ka qënë dhe mbetet (dhe për sa kohë nuk e di) problemi i refugjatëve Shqipëtarë në tokën Helene.

Pikërisht tek këta refugjatë janë derdhur inatet, të vjetra dhe të reja, herë me pikësnyime të caktuara politike e fetare e herë duke shfryrë veten mbi ta për faje të të tjerëve, por gjithnjë duke qënë vetëm të njëanshm edhe asnjëherë duke ardhur nga Shqipëria. Ngadalë e duke u trashur vazhdimisht me buzëqeshjen diplomatike në fytyrë ato harrijnë kulmin në verën e vitit 1999 pikërisht kur filloi lufta në Kosovë.

Pikërisht pas saj përçmimi Grek për Shqiptarët do të arrinte kulmin duke marrë formën e racizmit të plotë dhe duke sjellë të gjalla para njerzve skena të tilla të ngjashme me atë të Hitlerit, Pinoçetit, Millosheviçit etj, diktatorë të njohur.

Duke qënë dëshmitar i këtyre ngjarjeve dua t'ju kujtoj dhe një herë të gjithë atyre qindra-mijra Shqiptarëve atë periudhë dhe t'u them të tjerëve që s'kanë qënë, të vërtetën për tingëllimin e nocionit "alvanoz" në gojën e qarqeve të caktuara Greke duke përjashtuar popullin e thjesht Grek që ka ndarë me ne bukën e gojës, që kemi punuar e jetuar së bashku për qindra shekuj, secili në hallin e vet dhe bashkë kur e ka kërkuar historia.

Gjithçka filloi më 24 mars 1999, koha me shi që mbretëronte atë ditë mbi Athinë dukej sikur jo vetëm nuk do të ndryshonte, por do të nxihej dhe më shumë. Por askush nga nuk e mendonte se ajo natë do të gdhiehet me breshërinë e rëndë të predhave mbi Kosovë e Serbi.

Më në fund ishte prishur heshtja e Evropës dhe durimi i saj po derdhej i pamëshirshëm mbi ata që s'patën mëshirë kurrë për një popull krenar si Shqiptarët e Kosovës, për një popull martir, që mbijetoi dhe që kurrë nuk heshti së kërkuari lirinë e tij.

Atë natë ndodhesha në një lokal në lagjen Kipseli bashkë me disa miqtë e mi. Nuk u besova veshëve kur kreu i spikerëve të televizionit SKAI, "Niko Evangjelatos, i cili që nga ajo ditë bashkë me gazetarë të tjerë grekë si Traga, Kaneli dhe gjithë armata e gazetarëve Grekë të dërguar në Beograd do të tundnin me dorë flamurin e antishqiptarizmit duke mbrojtur deri ne delir Milosheviçin, kasapin e viteve dymijë, "të cilin tani që po shkruaj e urren dhe populli i tij" do të deklaronte me lot në sy sulmin e Nato-s në ish Jugosllavi. Nxitova të dilja nga lokali me shpresën mos takoja ndonjë nga të njohurit që ishte më i mirëinformuar dhe rrugën për ne shtëpi e bëra ne këmbë, por në atë kohë nuk mund të takoja njeri.

Rrugës si i marrë përsërisja me vete: Më në fund!, më në fund deisa arrita në shtëpi.

Kur hyra brenda i lagur deri në palcë gruaj më tha:

- Ç'je bërë kështu pellg, o i zi? Nuk kishte urban?
- Jo – ia ktheva – i ka ngrënë Millosheviçi.
- Fillove ti, - ma ktheu ajo – do ti hapësh punë vetes dhe neve.
- Mos ki merrak – i thashë – kanë me se të merren tani.

E çova televizorin në të gjitha stacionet që japin lajme dhe të gjitha jepnin sulmin mbi ish Jugosllavin.

Nëpër trurin tim si në një ekran filloi urushkullonte gjithë historia e Kosovës.

Që të jemi realë brezi ynë njeh mirë pikat kulminante të kësaj historie, jo vetëm sepse janë për tu njohur, por edhe për faktin sepse ato në shekuj nuk kanë qënë kurrë të ndara nga përpjekjet mbarë Shqiptare për liri, pavarësi e bashkim kombëtar. Askush në botë, qoftë Anglez a Serb, Amerikan a Grek, Turk apo Gjerman nuk e mohon dot Manastirin, 1912 e I. Qemalin e Isa Boletinit, konferencën e Londrës, e qindra fakte të tjera që tregojnë plotësisht se pavarësisht nga vijat kufitare, të papërfillshme për Shqiptarët, kombi Shqiptar ka vepruar si një i vetëm për te përballuar presionet shekullore nga fqinjët e ti brenda Ballkanit, por dhe jashtë tij.

Në këtë luftë titanike brezash, i vetëm e pa mbështetje, populli Shqiptar dhe inteligjenca e tij nuk u lodh e nuk reshti kurrë, nuk u shpërbë e nuk u ç'shqiptarizua, por përkundrazi u ngrit në piedestalet e kombit paqësor që kurrë në historinë e tij nuk i kaloi kufinjët Ilirian, për të pushtuar tokat e të tjerëve. Njihen mirë në botë miliona pushtime për askush nuk njeh asnje pushtim Shqiptar. Brenda territorit Shqiptar nuk ka asnjë pëllëmbë toke të huaj. Janë të tjerë ata që i kanë borxh toka Shqipërisë dhe Shqiptarëve. Janë të tjerë ata që me armatat e tyre kanë plagëruar supet e Shqipërisë. Janë të tjerë ata që dhe sot e kësaj dite derdhin miliona për të ndryshuar hartën e Ballkanit, janë të tjerë ata që varfërinë e sotme Shqiptare e përdorin jo vetëm për të fituar kredo politike në vendet e tyre, por edhe për të realizuar ëndrrën stërgjyshore të pushtimit.

Të veshur, jo më me frakë, por me gravatat moderne të viteve 2000, ngrihen nëpër endrra pashallarë të tokave Shqiptare.

Dhe Shqiptarët vetëm buzëqeshin. Azgjë nuk e ndryshon historinë. Popujt historinë e gdhendin me gjakun e tyre, dhe nuk pyesin asnjë kur e gdhendin. Ajo mbetet e përjetshme dhe para saj nuk ka titanë. Ajo vet është aq titanike sa i bën të kërrusen, bretër e perandorë.

Shumë historianë të shquar të të gjitha kohërave, Anglezë, Austro-hungarezë, Francezë, Gjermanë, Amerikanë, Shqiptarë i kanë analizuar dhe vërtetuar plotësisht kufinjët e vërtetë të trojeve Shqiptare. Unë jam i pa aftë përpara tyre por jam i saktë për të vërtetuar tezën e tyre.

Shqiptarët në Ballkan janë dhe do të mbeten përjetësisht në trojet e tyre, me gjuhën e tyre, me historinë e tyre, traditat dhe zakonet e tyre, dhe për këtë nuk i marrim leje njeriu, i çfardo kombësie qoftë.

Por le të kthehemi prapë tek ai fund marsi

Gazetat Shqiptare në Athinë vijnë një ditë më mbrapa. Kështu që nuk kishte asnjë mundësi për të marrë të dhëna të tjera veç medias Greke. Ajo ditë e 25 marsit mbarte me vete për ne shqetësime të mëdha.

Evropa na kishte ngrënë në besë më 1913. Dhe jo vetëm atëherë. Intuita jonë, edhe pse ajo kishte marrë një hap, nuk na linte të ishim shumë entuziastë. Gjithnjë ishim djegur. Gjithnjë e kishim pësuar. Mbas çdo beteje gjithnjë ishim pakur. Fatin tonë e vendosnin të tjerët. Ashtu po ndodh dhe tani. Trurin tonë e lodhnin mijra pyetje. Vërtet do bëhet Kosova? Jo, kurrë! Si do bëhet? Mos mbetet prapë nën juridiksionin Serb? Po pse filloi lufta? Rusia ç'bën? Si e la vetëm Serbinë? Mos plasë lufta e tretë botërore? etj, etj, që nuk u jepnim dot shpjegim, vetëm në vizion ishim të një mendimi: tani do bëhet më mirë!

Stacioni CNN u bë për ne lajmëtari i parë. Atje dëgjonim presidentin Klinton, Blerin, Shreder, por dhe Jelcin, Milosheviçin etj. Dhe bënim bilancin midis lajmeve Greke dhe atyre evropiane, amerikane. Absolutisht të kundërta.

Lind pyetja. A e dinin qeveria dhe politikanët Grekë se çdo ndodhte në Kosovë?. Patjetër.

Çështja Kosovare kishte vite që ishte shtruar në tavolinat politike evropiane të të gjitha rängeve dhe të të gjitha ngjyrave. Ajo ishte çështje që kërkonte zgjidhje urgjente politike sepse në fund të fundit vërtetonte botërisht demokracinë e Evropës. Ai shtet apo politikan që nuk mbështeste një zgjidhje përfundimtare të këtij problemi vinte në dyshim qënien e tij demokrat, dhe jo vetëm të tij por të gjithë atij populli që përfaqësonte. Kupa "Milosheviç" ishte mbushur dhe po derdhej dhe Evropa duhej të merrte masa që të mos qelbeshin sokaket e saj. Politikanët Grekë ishin brenda në këtë tavë. Shteti Grek është anëtarë i pesëmbëdhjetshes, anëtar i NATO-s dhe ka firmosur të gjitha dokumentat ndërkombëtare.

Nuk e di qëndrimin e përfaqësuesit Grek në mbledhjen e Brukselit kur NATO vendosi të sulmonte mbi Milosheviçin, por një gjë është e saktë. Qeveria Greke e trembur nga dobësia fetare që ka populli Grek per popullin Serb, nuk e tha hapur qëndrimin e saj ndaj Milosheviçit po ndoqi taktikën e vjetër me dorëzimin e Hoxhaleanit tek Turqit duke u bërë si e pa ditur. Dihet ç'pësoi Hoxhaleani, dihen dhe Kurdët në Greqi, që dolën nëpër sheshedhe kërkonin lirinë e tyre me flamurin Serb në dorë, nën drejtimin e Miki Theodhoraqit, Aleka Paparigës dhe Liana Kanelit.

Jam i bindur që përballë llogjikës evropiane përfaqësuesit Grekë, megjithë teorinë e tyre të politikës diplomatike kanë qënë në marveshje të plotë me Evropën dhe Amerikën. Nuk kishin ç'bënin ndryshe. Jashtë llogjikës për ç'do njeri firmosin psikiatrit çmendurinë.

Dhe çmenduria e politikanëve Grekë do te ishte katastrofike për Greqinë. Një ditë populli Grek do ta kuptojë këtë.

Loja e dyfishtë që bëri qeveria Simiti në luftën NATO-Milosheviç nuk shpëtoi nga syri i njerëzve të thjeshtë e jo më politikanëve Amerikanë dhe Evropianë.

Në dorë politikën dhe analizën e saj i mori media Greke, me përfaqësuesin e saj kryesor televizionin SKAI. Të mjerët kujtonin se Evropa i dëgjonte.

Po le të vazhdoj:

Qindra mijra Kosovarë morrën udhën e refugjatit. Pamje rrënjëthënëse. Kush i pa dhe nuk dedhi lot nuk ishte njeri. Vet Klintoni fliste në radion dhe televizionin Amerikan me lot në sy. Evropa përjetonte një "Ikje të madhe", sipas titullit të librit të Albert Zholit. Shqipëria përjetonte një dhimbje të madhe, Kosova një shpresë të madhe. Udhët e Kosovës mbusheshin me viktima. Satëri policor korre pamëshirshëm jet Kosovarësh pleq, gra, fëmijë, burra. U.Ç.K rriste radhët e saj me djem dhe vajza dhe mudohej sadopak të ndihmonte popullin për emigrim. Mbrapa krahëve të karvanëve të refugjatëve të masakruar, gjuhët e flakëve përpinin çdo gjë. Gra të përdhunara deri dhe shtatë muajshe shtatëzëna mallkonin me lot në sy farën Milosheviçiane. Fëmijë të vegjël që s'flisnin dot nga trauma u ishin vrrarë komplet familjet, varret e përbindëshme të përbashkëta u hapën mbi trupin e Kosovës si dëshmitarë të pakundërshtueshëm të reпреzaljeve të ushtirës Serbe.

Gjithë bota ndiqte me shqetësim këtë tragjedi të paparë. NATO, me bombardimet e saj në pika strategjike luftonte me çdo kusht që ta minimizonte sado pak tragjedinë, por përballë saj qëndronte fuqia shtazarake Serbe dhe logjika e çmendur e Milosheviqit dhe pasuesve të tij.

Në median Greke si kudo vendin e parë të lajmeve e zuri pikërisht kjo ngjarje, por mjerisht jo për të vërtetën por për tu rreshtuar plotësisht në krahët e vrasësit Milosheviq duke shkelur plotësisht çdo gjë demokrate për çdo media. Bateritë e saj punoni me ngarkesë të plotë për të mbuluar krimet që bënte ushtria Serbe.

Kush ka mundësinë që të ndjekë arshivat e TV. SKAI nëse ato nuk i kanë zhdukur, të kësaj periudhe nuk ka sesi të mos akuzojë i indinjuar për racizëm.

Nëpër gjithë Greqinë filluan të bëheshin koncerte masive, demonstrime, djegie falumunjsh të Amerikës, Anglisë, komuniteti Evropian etj, NATO u cilësua si xhandari i lirisë së popujve, Klintoni si Hitleri, Ollbrajt në faqen e parë të një reviste nudo duke bërë seks me Klintonin, e lloj e lloj maskarallëqesh të cilat bota i ka parë dhe bindet dhe vetë për këtë media raciste dhe tejet te fetarizuar, pa asnjë lloj sensi demokratik.

Nuk ka seç të mohoj TV, SKAI se vetëm reklama për ndihmë të popullit Serb ishte e gjithë me fëmije Kosovare me lotë në sy, vetëm pamjet që tregonin varganët e refugjatëve Shqiptarë shoqëroheshin me këngë Serbe. Ç'ironi dhe turp për ta. Ne ishim mësuar me këto gjëdrime dhe nuk kishim asnjë problem. Lajmet i kthenim në të kundërtën për të mësuar të vërtetën. Nuk e di në ka ndonjë organizatë botërore kundra racizmit, por nëse ka asaj i duhet vetëm të vërë përpara një gjykatë nga çdo vendi botës që të jetë, kasetat e emisioneve të lajmeve dhe ajo patjetër do të dënojë e vulën e turp të racizmit.

Le ti zëmë me radhë ato që treguam më lart.

Mitingjet me koncerte:

Metoda e koncerteve në rrugë në përkrahje të një ideje të caktuar ishte përdorur në Athinë e qytete të tjera Greke edhe para problemit Kosovar, ishte e freskët në sytë tanë rasti i koncerteve për Kurdët. Dorëzimi i Hoxhalanit në qeverinë Turke tani, por edhe atëherë nuk kishte dhe nuk ka asnjë dyshim që është vepër e qeverisë Greke. Populli i thjeshtë Grek e kuptoi manovrën qeveritare dhe e deklaroi hapur atë. Fluturimi i Hoxhalanit nga Moska në Greqi dhe pako postare në Ankara, mori me vete disa ndryshime në qeveri duke përfshirë këtu dhe shkarkimin e ish ministrit të jashtëm Pangallos të akuzuar si aktorin kryesor të kësaj tragjedie. Pikërisht atëherë u çfaqën koncertet e bashkimit Kurdo-Grek. Këngëtarë dhe artistë të njohur edhe Kurdë protestonin në sheshe në mbrojtje të Hoxhalanit. Më pasë në mitingjet koncert Kurdët do të protestonin në mbrojtje të popullit Serb bashkë me Grekët, por asnjëherë në mbrojtje të popullit të Kosovës që digjej e shkatërohej.

Të mjerët Kurdë. Ishin rreshtuar symbyllurazi në krahun e atyre që ua shitën udhëheqësin e tyre si një kec. Por qëllimi im nuk është të flasë për këtë temë. E hapa këtë parantezë për të arritur tek koncertet anti-shqiptare në grackën e të cilëve ranë dhe figura të njohura të artit, muzikës dhe letrave Greke.

Flamurin e këtyre aktiviteteve e morinë dorë kryesori Miki Theodhoraqi i cili në fund të luftës do të udhëtonte bashkë me avokatin e Milodheviqit, Likurezo për në Beograd i dërguar nga qeveria Greke me avion luftarak. Ç'të bënin, por nuk morrën me vete dhe një prift ti bënte adetet e fundit para gjyqit të Hagës ku do të përgjigjet për genocidin e tij të pashembullt karshi Shqiptarëve.

Asnjëherë dhe në asnjë moment në këto kanalet nuk u fol qoftë dhe një fjalë e vetme për Shqiptarët, por vetëm për Serbët që luftonin heroikisht në vendin e tyre. Në tavolinat televizive dolën nga sirtarët kufinj të vjetër të Serbisë, ku Kosova ishte patjetër Serbe dhe Kosovarët pushtuesit e saj. Është pikërisht ky momenti në të cilin do të dalin para syve të shikuesve Grekë e Shqiptarë disa figura të spikatura të historisë e kulturës Greke, por dhe Shqiptarë si A. Kola, Çela, Zaçe, Miçi etj, që do më falin që nuk i kujtoj dot emrat e tyre, por që do mbeten në historinë e kësaj periudhe si njerëz të së vërtetës, të arsyesh, të botkuptimit demokrat.

Pikërisht këta intelektual me vizione të gjera, do të shpalosnin të vërtetën historike dhe to të hapnin dritare shprese që ajo të dukej ashtu siç ishte. Ndaj nuk kishte sesi që mbi ta mos binte anatema e fillo-serbëve që do të arrinte kulmin me kërcënimin e gazetares Kaneli për të hedhur ne gjyq zotin Aristidh Kola. Aq shumë i shqetësonte qëndrimi i A. Kolës dhe F. Nikës gazetarët televizivë sa i identifikonin me njëri tjetrin dhe një natë në emisionin e ljameve në titra u ngatëruan emrat.

Kola me të qeshurën e tij karakteristike u kujtoi emrin e tij dhe ata e ndryshuan. Këta të dy shkencëtar, por edhe të tjerë, njëri me buzëqeshjen simpatike dhe tjetri me qetësinë klasike, por të dy me logjikën e hekurt, u bën figura shumë të dashura për Shqiptarët në Greqi dhe ne që kemi qënë dëshmitarë okularë të atyre ngjarjeve, do ti kujtojme me nderim dhe respekt, pavarësisht se shumë pak i njohim personalisht.

Emrat e tyre do të zënë vend në historinë Shqiptare, dhe do të përmenden brez pas brezi duke u kujtuar të gjithëve se vetëm kur shkencëtari shkëputet perfundimisht nga pradokset, bëhet i pavdekshëm me veprën e tij.

Çdo vepër e çdo lloji qoftë e mbyllur në kornizën e gënjeshtres për hir të konjunkturave të çastit është e detyruar të shkojë në koshin e plehrave duke u mbushur turpërisht nga pluhuri i harresës.

Dy janë temat kryesore që u trjatuuan gjerësisht gjatë kësaj kohe dhe që ishin pjellë e kulshave të klaneve anti-shqiptare.

E para “Shqipëria e madhe”. Gazetarët rendnin ku të gjenin ndonjë që të përmendte sadopak këtë zonë delikate për ta. Mos ndryshimi i sinoreve ishte tema kryesore dhe e përditëshme e politikanëve. Ky nerv delikat i trupit të Ballkanit do të hapte plagë të vjetra të shume përpara 1913.

Ndërsa Shqiptarët donin në radhë të parë lirinë e Kosovës, qarqet e lidhnin këtë liri me bashkimin e saj me Shqipërinë. Edhe sot i painformuar mirë në këtë drejtim nuk e di se ç’lloj plani do të zbatohet nga politika ndërkombëtare përkëtë pikë. Ajo ka shumë pika që i bashkon politikanët, ka shumë pika që i ndan ata, ka shumë dëshira, shumë dyshime, por një gjë është saktë Kosova nuk do jetë më nën diktatin Serb dhe as në mëshirën e të tjerëve, ajo me gjakun e saj vulosi të ardhmen dhe kurrë s’ka për tu kthyer më në koloni të ndonjërit.

Mendimi im personal dhe i palëkundur është që ajo do bashkohet me atdheun e saj se boll ka qënë e huaj në vatrën e vet.

Koha do ta vërtetojë se çdo ndodhë, por as ne, as politikanët tanë nuk kanë sepse trëmben nga një ide e tillë e bashkimit. Ajo do vijë në rrjedhë e synimeve që i ka vënë Evropa vetes dhe askush nuk do ketë të drejtë të flasë as për shovinizëm Shqiptarë dhe as për pretendime për superfuqi Ballkanike. Kujdo që s’do ti vijë mirë le të bëj që tani gati notat e protestës për organizmat e rëndësishme ndërkombëtare. Bota do ecë përpara duan apo s’duan nostalgjikët. Ajo do të ndërtojë një Evropë të re, larg synimeve, pushtuese, të barabartë pa më të voglin sens racist, apo të kombit të privilegjuar. Ata që do të mbeten jashtë këtyre synimeve do të tregohen me gisht se do të jenë pak. Ne Shqiptarët nuk duam të ketë asnjë të tillë, por siç duket mbase ndonjë dhe do jetë. I mjeri ai komb për ata që e drejtojnë.

Attëherë vetë ai komb do ti shkel me këmbë këta morra, dhe do të kërkojë të drjetësohet shpirtësisht e të lulëzojë moralisht si gjithë të tjerët. Dhe kjo ditë nuk do të jet larg. Evropa po punon hap më hap për të.

Njerzit duan paqe e aq më shume ne Shqiptarët që shkujt na kanë hedhur mbi luftra të mëdha.

Së dyti: U.Ç.K-ja në Greqi.

Nuk e di ç’drej mëndje e polli këtë. Për një gjë duket mirë. Ajo u bë aq e pranishme në mëndjen vëndase sa të dukej sikur batalionet e U.Ç.K-së stërviteshin e armatoseshin në rrugët e Greqisë dhe niseshin në mënyrë klandestine për në Kosovë.

E vërteta është ndryshe.

Në një fshat, në një ishull, policia grumbulloi rreth njëzet Shqiptarë dhe i nisi në Shqipëri.

Me njëherë aty arrijnë gazetarët e SKAI-t dhe njoftojnë që janë larguar Shqiptarët me dëshirën e tyre për të vajtur në U.Ç.K me një rrogë prej 20.000 dhrami në ditë. Midis shumë të intervistuarëve foli dhe një fshatar i thjeshtë Grek. Ai pohoi ikjen e Shqiptarëve. Por jo qëllimin e largimit të tyre.

- Unë di- tha plaku- se shumë Shqiptarë janë larguar nga fshati, por a i kapi policia, apo për qëllimin tjetër, nuk e di.

U nxituan të intervistonin dhe Shqiptarë të cilët mbrojtën NATO-n për luftën në Kosovë dhe shpjeguan që djemtë e Kosovës janë në gjendje ta mbrojnë vet dheun e tyre dhe Shqipëria nuk do të ndërmerre asnjë hap për luftë vetëm nëse Milosheviçi sulmote Shqipërinë.

- Ne- tha një refugjat Shqiptarë në televizion- nëse sulmohet atdheu ynë të gjithë do të largohemi këtej për të mbrojtur vendin tonë.

Po atë ditë u gjet një mjekërosh, racist i çmendur, që deklaroi në debat me zotin Çela, se kishte parë në Kretë dhe Athinë me sytë e tij stërvitje të Shqiptarëve për në Kosovë.

Ndërkohë televizioni ilustronte fjalët e tij me reparte të U.Ç.K-së që stërviteshin në Tiranë a gjetkë në Shqipëri. Përballë kësaj, Zoti Çela i kërkoi atij dhe kameramanëve që të shkonin të filmonin sëbashku. Racisti, që më vonë do ti thoshte zotit Kola në një debat tjetër: Se marrë vesh se me kë je ti zotëri, shkumëzoi dhe nga që nuk kishte asnjë fakt kërkoi ndërprejen e debatit me pretekstin se zoti Çela ishte o paligjshëm ne Greqi. Kur të fillonte operacioni i policise “skoupa” fshesa, kundër shqiptarëve ai do të çfaqej prapë në ekranin famëkeq dhe do të derdhte tërë urrejtjen e tij për Shqiptarët.

Kaq u besua përralla e U.Ç.K-së në Athinë sa që policia ndalonte këdo që dyshonte dhe e kontrollonte. Një rast i tillë na ndodhidhe ne një ditë.

Me miqtë e mi Pëllumbin dhe Vason, udhëtonim për të takuar një mikun tonë që i flisnin Bale, ardhur ato ditë në Athinë. Policia sa pa makinën me targë Shqiptare, urdhëroi të ndalonim. E rethuan makinën me të bërtiturat e tyre karakteristike dhe me duar në kobure na kërkuan dokumentat.

Ne i kishim të tre të rregullta dhe mbasi kontrolluan fije për pe makinën njeri mu drejtua mua.

- Ku punon - më tha
- Nuk punoj - i thash
- Kush të ushqen ty? – nguli sytë jeshil të tij në fytyrën time.
- Djemtë – i thash
- S’na e hedh dot neve, ti je ushtarak i U.Ç.K-së

Unë buzëqesha.

- Jam poet – i thash – jo ushtar. U.Ç.K do djem të rinjë të luftojnë unë jam plak për ta bërë atë.

Kur na lëshuan në makinë ia morrëm një këngë labe. Aq bukur vajti ajo këngë sa nuk na kishte vajtur ndonjëherë.

Më mirë që mendojnë kështu, thamë me njëri – tjetrin, duke kërkuar U.Ç.K-në këtu, nuk merren me Shqiptarët.

Dhe vërtetë: Sa zgjati lufta në Kosovë pak u muar policia Greke me Shqiptarët.

Ata do merreshin me ta me egërsinë më të madhe, por më parë në kuzhinën e SKAI-t do të gatuhej çorba që do hanin politikanët Grekë për të aprovuar një ligj sa antishqiptarë aq dhe të pa paranueshëm për çdo vend të botës. Dihen përpjekjet e politikës botërore, por sidomos Euro-Ameriakane për luftën në Kosovë. Ato nuk ishin të fshehta, por për kundrazi, të hapura, të lexueshme dhe me synime të qarta. Vetë presidenti Klinton në mesazhin që i dërgoi popullit Serb në fillim të luftës e sqaron publikisht atë për hapat që do ndërmerre NATO, në Kosovë.

Është fatkeqësi që ai popull vajti viktimë e neonazistit Milosheviç dhe nuk dëgjoi zërin e arsyes. Ai verbërisht e besoi udhëheqësin e tij tiran sa që një Serb në televizionin Grek deklaroi “ Ne jemi 10

milion Milosheviç”. Kjo verbëri e çoi atë popull në një katastrofë të tillë politike dhe ekonomike sa do ti duhen disa vjetë për të rregulluar atë ç’ka u prish.

Prëzimi i Milosheviçit dhe larove të tij do ti kishin dhënë vërtet një drejtim tjetër asaj lufte dhe nuk do ishin hapur kaq varre Shqiptare, por dhe Serbe.

Por dhe sot megjithatë që ndodhi nuk është vonë që ta heqë nga trupi atë kërpushë të pangopur me gjak dhe të marrë si gjithë kombet e tjera udhën e demokracisë së vërtetë.

Sa më shpejt ta kuptojë këtë aq më mirë do të jetë për të.

Lëvizjet politike në Evropë në ato muaj ishin të shpeshta, por gjithnjë binin në veshin e shurdhër të Milosheviçit. Udhëheqësit Evropian dhe Amerikan ishin për zgjidhjen e problemit sa me shpejt.

Lëvizjet e Milosheviçit ishin të pashpresa por hileqare si të gjithë diktatorëve. Gjyqi i hapur në Hagë e akuzonte atë për krime të përbindëshme.

Drejtësia nuk falte gjaku i të rënve kërkonte shpagim.

Më në fund politika botërore do ti arrinte synimet e saj dhe Milosheviçi do tërhiqej në skutën e tij.

Kosova filloi të marrë fymë lirisht dhe ne këtu në Greqi prisnim një politikë të re nga qeveria Greke.

Nga ta dinim se pas pak ditësh nga mbarimi i asaj lufte, mbi ne do të derdhej furishëm inati për humbjen e Serbisë.

Ishim pa asnjë mbrojtje ligjore, me një shtet tonin të varfër e të raskapitur, kishim 9 vjet që përdorshim sipas orekseve të pronarëve dhe policisë Greke.

Fjala Shqiptar ishte identifikuar me fjalën turp sikur kombi ynë dhe atdheu ynë të mos egzistonte fare.

Problemi i legalizimit të refugjatëve në këtë vend ka qënë gjithnjë i hapur për të dy palët e ndoshta dhe për të tjerë, por asnjëherë deri sot nuk ka gjetur zgjidhje.

Gjithnjë është folur për arritje në këtë drejtim. Por e vërteta është se dhe sot e kësaj dite Shqiptarët në Greqi jetojnë me frikën e largimit të përhershëm. Ky kërcënim i vazhdueshëm i ka bërë Shqiptarët që të jenë të kujdesshëm në mardhëniet me Grekët.

Këtu bëhet fjalë për Shqiptarët dhe jo për llumin e tyre, hajdutët, vrasësit, kriminelët të cilët lidhen ngushtë me vëllezërit e tyre Grekë shijnë si të duan në të dyja anët e kufinjve të paprekur nga askush. Mbretër në aktivitet e tyre i kanë bërë Shqiptarët këtu pre e politikave konjunkturale që zbatohen sa herë qeveritarëve Grekë u ngelet hatri nga politikanët e Tiranës. Gjendet gjithnjë një rast vjedhjeje, disa dyqane armësh, disa njerëz që dalin me dyfeqe për të vrarë Shqiptarët dhe makina policore vihet në levizje.

Kështu po ndodh dhe këtë verë të nxehtë të vitit 1999.

I ndodhur si refugjat njoh nga afër hallat e tyre, punët e tyre, lotët, dufet, por jo këngët, kënga është larg. Ajo nuk duket akoma në horizontet e refugjatëve Shqiptarë.

Objektivi i shënimeve të mia është tjetër dhe jo ai i trajtimit të çështjeve që përmenda. Ndoshta në një kohë tjetër do flas dhe për to, por tani fryn fuqishëm mbi tokën Helene antishqiptarizmi. Ai na vret shpirtin, na vret jetën, na vret këngën. Shumë shkrimtarë, gazetarë, poet, Shqiptarë në kohë të ndryshme i kanë trajtuar këto çështjedhe në veprat e tyre kullojnë lot e dhëmbje dhe pak shpresë. Sa pak shpresë për të ardhmen tonë. Do doja, si gjithë Shqiptarët refugjatë që veprat e tyre, të mbeteshin si një kujtim i hidhur i një kohe të harruar. Në ndodhtë kështu do jemi më të lumturit. Ndodhtë kështu. Flamurtari antishqiptarë SKAI, hapi thesin e lajmeve të tij një natë të bukur fundqershori. Zëri metalik i Evangjelatos lajmëronte popullin Grek për të zezat që i kishin filluar të bënin kohët e fundit “ oi alvanoï kakopioi”, Shqiptarët keqëbërës.

Në një zonë në Mesologji ishte vrarë me armë zjarri një avokat, vrasësi nuk ishte zbuluar nga policia, por patjetër, sipas lajmeve, fliste greqisht përçart pra ishte Shqiptar. Aksion i shpejt i policisë dhe mobilizimi i fshatit dhe të gjithë Shqiptarët refugjatë u nisën për në Kakavi.

Në Pire vidhet dhe gjendet e vdekur një plak në një shumëkatësh. Vjedhësit nuk gjenden nga policia, por nuk ka nevojë. Sipas intervistave të ca plakave të rrudhura njëqindvjeçare, hajdut flisnin përçart greqisht pra janë Shqiptarë.

Kaq u desh dhe SKAI bën thirrje, “të gjithë të denoncojnë vjedhjet e Shqiptarëve”. Ne kemi patur rastin të shohim intervista bajate, të improvizuara, me njerëz hysterikë që nuk heshtin përpara asnjë logjike që jo vetëm nuk vërtetojnë gjë, por të ngjallin neveri. Të vjen në mendje mesjeta, aq trashë e aq pa profesionalizëm bëhen.

Kujtuam të gjithë se e theu rekordin një burrë që e kishin vjedhur Shqiptarët dyzet herë dhe nga gratë, një grua e vjedhur katërbëdhjet herë.

Nga ata që këto i quanin badallallëqe, u bë pyetja: a kishin kapur ndonjë?

Përgjigja publike ishte: JO.

Ndërkohë në prisnim që SKAI të jepte ndonjë çmim për të dëmtuarit, por kushtet nuk ishin pjekur. SKAI kërkone rekorde më të mëdha. Dhe kur i do rekordet dhe i gjën.

Një telefonatë e largët njoftonte që e kishin vjedhur gjashtëdhjet herë megjithse flinte me pushkë nën kokë. Dhe ky i varfëri nuk kishte zënë ndonjë.

Vasisliadhi, kryetari i një shoqate të të vjedhurve, deklaroi që 85% të vjedhjeve në Greqi i bëjnë Shqiptarët.

Me frikë prisnim çdo natë lajmet, ndërsa qeveria përgatiste ligjin dhe policia planin e askionit antishqiptarë “skoupa”. I dinim rezultatet e këtij aksioni famëkeq. Ishte zbatuar dhe herë të tjera për ne. Por na mbante shpresa se qeveria dhe parlamenti Grek nuk do të binin në këtë grackë. Kishim gabuar.

Dy ngjarje të mëdha e përshkuan Evropën dhe Greqinë në këtë pranverë.

Festimi i 50 vjetorit të NATO-s dhe zgjedhjet e reja të Parlamentit Evropian.

Të dyja këto ngjarje do të linin gjurmë edhe në ndegjegjen e Shqiptarëve refugjat. Akuzat që i bëheshin NATO-s nga opinioni Grek si pushtuese, armatë Hitleri etj, çuditërisht iu shpërblyen në festë me buzëqeshjen servile të Simitit.

Firma që hodhi solemnisht Simiti, si gjithë kryetarët e shteteve pjesëmarrës në bllok nuk e uli aspak në Greqi tempin e urrejtjes për NATO dhe Amerikën. Përkundrazi hapur sulmohej nga turma të pakontrolluara vendqëndrimi i forcave të NATO-s. Selaniku u bë një pikë e nxehtë ku të quajturit komunistë të Aleka Papanigës, KKE thyenin xhama makinash dhe në mos gaboj për identitetin, dy ushtar Francezë i keqtrajtuarn.

Qëndrimi antiamerikan dhe antinatos ishte në rend të ditës. KKE (partia komuniste Geke) botonte fletushka shqip dhe greqisht ku u bëhej thirrje punëtorëve shqiptar për luftë të përbashkët kundër imperializmit amerikan si armik i përbashkët i proletariatit botëror.

Një mbrëmje tek po prisja një shok në parkun Pandelejmon më afrohet një aktiviste e KKE me një fletushkë të tillë në dorë.

Minifundi i saj më bëri për të qeshur. Komunistet e moderuara më jepnin në dorë një thirrje kundër imperializmit.

- Ç’është kjo – i thashë
- A nuk jeni Shqiptar, më tha.

Mbasi kisha folur e dija që do ta kuptonte që isha Shqiptar. Unë nuk e dija mirë gjuhën greke. Por deri në atë moment që kish marrë fletushkën nuk kisha folur.

- Jam i thashë – kaq shumë njihem?
- Jo – tha ajo dhe qeshi, duke treguar librat që kishte në dorë. Ata ishin libra Shqip.
- I ktheva buzëqeshjen dhe e pyeta përse fliste fletushka.
- Të bashkohemi kundër NATO-s dhe imperializmit Amerikan – më tha.
- Merre, i thashë dhe i zgjata fletushkën – unë e luftova 50 vjet Amerikën, tani e keni radhën ju, dhe u largova.

Nuk kishte si të ndodhte që Shqiptarët edhe pse refugjat të hidheshin në aleanca të tilla ne mezi e kishim pritur atë ndërhyrje.

Tjetri ishin zgjedhjet që u zhvilluan në fillim të qershorit për parlamentin Evropian.

Dihet që të gjitha fushatat zgjedhore kudo që behen, politikanët hapin thesin e gënjeshtreve dhe populli i dëgjon gojëhapur duke ëndërruar për të mirat që do tu sjellin këta burra shteti. Dihet pastaj dhe të mirat që vijnë mbasi vënë bythët në karrige. Ka shekuj që ndodh kështu dhe kështu do të ndodhë. Të paktën ti bëjmë zgjedhjet më shpesh që të ngopemi me lugë zbrazur. Por ne s'kishim hallin seç do bënin politikanët grekë. Në të gjitha fjalimet e tyre padyshim çështja e refugjatëve ishte kryesorja. Dhe të gjithë me rrathë kryetarët e partive e trajtuan atë. Rezultantja ishte e njëjtë. Largimi i tyre nga Greqia. Në disfavorin Shqiptarë në atë kohë ishte çështja e emigranti që rrëmbeu një autobus grek me pasagjer dhe policia shqiptare vrau atë dhe një djalë grek nga Skalari i Selanikut. Ngjarja ishte e rëndë dhe ne e gjukonim të tillë, por jo të bëhej shkakë për te quajtur të gjithë shqiptarët si terrorista. Mirpo kush na pyeste neve. Z. Smiti, Karamanliu e sidomos Samara që nuk hariti të marrë as 2% në zgjedhje ngulmonin shumë në këtë pikë. Dihej opinionin antishqiptar ishte i ngrehosur dhe secili donte të fliste sa më shumë.

Në fjalimin e tij z. Samara nuk la gjë pa thënë për shqiptarët dhe kujtoi të gjitha epitetet që kishte mësuar që kur ishte i vogël. Ne prisnim në heshtje çdo ndodhte.

Në Greqi nuk ka ndonjë organizëm të dukshëm të shqiptarëve për shumë faktorë.

Në biseda të ndryshme që kemi bërë me shokë që kanë tentuar të bëjnë një gjë të tillë të thonë se ka shumë pengesa qoftë nga shteti grek për sidomos nga politika që i vë në shënjestër aktivistët shqiptarë. Mund të vërtetoj disa raste të tilla, por këtu nuk është vendi. Një e keqe tjetër e madhe është se sa fillon të marrë udhë një organizatë fillon lufta për kryetarin dhe çdo gjë nis nga e para. Ndaj dhe deri tani nuk ka ndonjë oraganizatë prestigjioze që ti grumbullojë të gjithë reth saj. Përpjekjet e intelektualëve për botimin e dy gazetave janë më shumë thjesht përpjekje të pasionit, megjithëse janë shumë për tu përgëzuar. Por ato janë të pafuqishëme për të arritur synime të caktuara për të drejtat e shqiptarëve. Ndryshe ndodh me refugjatët e tjerë. Ata kanë, kishat e tyre, shkollat e tyre, libraritë, dyqanet etj. Ndaj dhe tubimet shqiptare në Geqi janë të pakta, për të mos thënë hiç fare.

Kjo mungesë organizimi sjell me vete dhe pasojat e saj. Së pari palegjimitetin e tubimit, e pastaj me radhë. Gjatë kësaj kohe vetëm një tubim i tillë u bë dhe u bë diskutim i madh televiziv sepse në përkrahje të Kosovës bashkë me flamurin Serb u dogj dhe flamuri Grek.

Këtu çdo gjë harrit kulmin!

Aksioni i policisë greke i kryesuar nga oficerët e lartë të Ministrisë së Rendit kishte ditë që kishte filluar, por racizmi do të harrinte kulmin në zonën e Palinit në Athinë. Policia e organizuar më së miri grumbulloi në fushën e sportit mijra Shqiptarë që vinin në punë.

Pa ujë, pa bukë, në sy të diellit të korrikut nën një keqtrajtim të paparë policor të mjerët Shqiptarë nisën udhën e kthimit në atdhe. Megjithëse secili priste rradhën e tij, të gjithë qanin kur i shihnin në atë gjendje.

Akoma deri kur do jetë kështu për Shqiptarët? Ç'bëjnë ata në Greqi?

Për nëntë vjet me radhë Shqiptarët në Greqi kanë bërë punë nga më të rrëndat dhe janë paguar shumë më pak, jo nga punëtorët grekë që as që bëhet fjalë. Por nga të gjithë refugjatët e tjerë, kjo për dy arsye.

E para sepse ata janë komplet të zbuluar ligjërisht. Për nevojat imediate që kanë patur e kanë shitur lirë krahun e punës. Pronarët grekë dinë ta gjuajnë mirë krahun e lirë. Asnjë tjetër veç Shqiptarëve nuk del në parqet për të kërkuar punë. Të ashtuquajtur zyra punësimi janë kthyer në zyra fitimi për drejtuesët e tyre. Jo vetëm që ketu radha e shqiptarëve është e fundit, por mbasi u marrin ca lekë i sorollasin derisa të mërziten.

Nga hallet që ka ai detyrohet ta braktisë këtë zyrë dhe të gjejë rrugë të tjera. E para është parku. Atje ai nuk bën më pazar. Por për bukë goje dorëzohet shpejt. Qesea e tij prapë është e boshatisur.

Ka këtu familje që janë integruar mjaft mirë me jetën greke. Fëmijët në shkolla(doemos greke) se për shkolla Shqipe as që bëhet fjalë. E vërteta është që shumë fëmijë nuk dinë Shqip. Mos tu duket çudi. Fëmijë 10-12 vjeçarë nuk dinë të shkruajnë e të lexojnë shqip. Rrofshin marrëvjeshjet. Mbas 5 vjetës minoriteti grek në shqipëri do të arrijë numër befasues për shtetarët tanë. Mijra të rinj, kanë ndërruar emrat e tyre falë zyrave të regjistrimit të degjeneruara shqiptare. Edhe pse shumica e këtyre familjeve nuk kanë dokumenta për to nuk është ndonjë problem i madh sepse ana ekonomike e tyre është e mirë. Të korruptuarit e konsullatës greke në Gjirokastrë janë të gatshëm kundrejt një shume të majme ti sjellin këtu prapë. Nuk flasë këtu për minoritarët sepse ata gëzojnë të drejta të tjera si bashkombas grekë. Elita e tyre është majmur plotësisht. Paguhet mirë nga klanet greke dhe sa herë u duhet atyre, udhëton nga shqipëria, për të treguar të zezat që kanë pësuar nga ne në kohën e diktatorit. Gjuha e gazetarëve dhe e kryetari V. Dule të 'Omonias': duket mirë në intervistat që kanë dhënë në kohën që po flasim. Shqiptarët nuk harrojnë këtu gjuhën me të cilën foli në SKAI, babi i të persekutuuarit, Piro Dhima. Jo vetëm që deklaroi qënien e tij grek në debatin me Z. Çela, por rrezik ta shkulte Himarën nga riviera e bukur Shqiptare dhe ta ngulte këtu në Athinë. Duke fjetur mbi milionat e qelbura të të birit sulmon pa pikë turpi, ish komunisti, një popull të tërë.

Fakti është që nëse do të kesh një çik rrugë të hapur këtu duhet patjetër të jesh vorio- epiriot.

Sipas nesh virio-epiri as ka qënë as do jetë kurrë. Le të rënkojë e të mos tretet Serafimi në varrin e tij në kufirin Shqiptarë.

Harta e Ballkanit është kjo që është. Ka ardhur koha që historianët shqiptarë të mbrojnë me forcë tezat e tyre për shkrirje territoriale të shqiptarëve në shekuj. Shoqata 'Çamëria'etj, le të mos merrem me zakonet e adetet e Çamëve por të piketojnë në kërkesat tyre atë më themeloren. Ku ndodhet dhe sa shqiptarë në fund të fundit është Çamëria.

Ka rreth 10 vjet që idhtarët e vori-epirit punojnë hapur për të realizuar qëllimin e tyre shovinist jo më me luftë, por me metodat që përmendëm më lart, rritjen falco të popullsisë, bërjen e lëshimeve etj.

Të mos harrojmë zotërrinj ngritjen e flamurit ne 1997 në Sarandë e Delvinë. Absolutisht nuk ishin spontanë. Ka ardhur koha që qeveritarët tanë të mos rrinë para qeveritarëve grekë me gojë të mbyllur, por të falsin me kompetenca. Të mos tremben se shkelin demokracinë. Nuk ka demokraci kur tenton të më marrësh vatrën. Atëherë ka vetëm një gjuhë. Dhe ajo gjuhë kur është për këtë problem flitet mirë nga shqiptarët.

E dyta për hirë të antishqiptarizmit.

Në se nuk ke emër ortodoks dhe nuk je vorio-epiriot, je shumë largë gjetjes së punës dhe shtëpisë.

Pronarët e shtëpive verifikojnë në polici pasaprotat tona. Në se ato ndodhen brenda kufijëve ku e endërrojnë ata vorio-epirin, fillon marveshja për shtëpinë.

Me rrogat që marrim këtu një njeri pa familje duhet të punojë gjithë muajin për të paguar qiranë e shtëpisë, dritat, ujët etj, dhe në këtë pikë shqiptarët janë shumë të regullt. Janë shumë të paktë, për të mos thënë fare atë pronarë që kanë pretendime. Ndyshe ndodh me refugjatët e tjerë.

Duke bërë kët llogaritje në një familje me dy krahë pune, kuptohet sa e vështirë është jeta. Mjafton të sëmuresh apo një hall tjetër dhe ato pak kursime gjaku të derdhen prapë në xhepat e grekëve.

Duhet theksuar këtu që tani, janë të paktë shqiptarët që flenë në kushte të vështira.

Kultura dhe personaliteti shqiptar janë prezantuar në mënyrë dinjitoze në këtë vend megjithëse racistët nuk duan ta pranojnë dhe habiten që Shqipëria ka mjekë, mësues, artistë, shkrimtarë që nga halli bëjnë punë nga më të rrëndat. Bëjnë sikur habiten që tek ne nuk ka analfabetë. Ata e njohin mirë Shqipërinë por qëllimet e tyre janë të tilla sa arrijnë dhe thonë, që ne po e mbajmë, ne po e mbajmë atë vend.

Dhe injorantët analfabetë grekë, që mezi hedhin firmat, ngrohin xhepat me djersën e gjakun e inteligjencës sonë për të cilën populli Shqiptarë ka harxhuar aq shumë.

Ç'ti bësh? Ky ishte fati ynë në këtë fund shekulli. Si oktapodi që ha këbët e tij, hamë njëri-tjetrin, dhe politikanët shqiptarë shtojnë radhë gushe me mashtrime e vjedhje mbi kurizin e popullit.

Së treti dokumentacioni që nuk kanë Shqiptarët, ose të famëshmet kartat jeshile. Edhe sot edhe pse një pjesë e shqiptarëve i kanë ato, duhet ti nënshtrohen kontrollit të rreptë policor. Merren në polici, mbahen në qeli dhe lirohen apo jo nuk dihet. Mjafton një kundërshtim i vogël dinjiteti dhe jo vetë që karta grisët po mjerë shqiptari që kundërshtoi.

Vetëm trari i Kakavies, sikur të kishte gojë të fliste, do tregonte për milionat e plagëve të marra.

Kriminelët grekë bëjnë kërdinë nën hundën e policisë, sepse fajet e tyre ua hedhin shqiptarëve, ose avokatët i nxjerin me të meta psikike.

Fakti që thjetra-mijra shqiptarë që janë kapur nga policia deri në këtë fund korriku, nuk ka dalë asnjë kriminel, akuzon pastër, pa asnjë avokat, për racizmin grek.

Përballë këtij fakti armata televizive greke po i resht sulmet e saj antishqiptare, e friksuar nga personaliteti shqiptar.

Era e demokracisë që fryn tani mbi Ballkan, nuk mund të pranojë më tezat e njohura Helene. Atyre u ka dalë boja. Cilido Shqiptarë, politikan apo jo politikan, në dejet e tij ka gjakun e nënës dhe kurrë nuk bën pazar me dhëmbjen e saj. Ata që bëjnë, u dihet fundi: në varrë të qenit!

Të flasësh për këtë periudhë duhen shumë faqe, por unë e shkurtova, që këto radhë le të mbeten si një kujtesë e hidhur në ndërgjegjien tonë.

A nuk akuzoj për racizëm, Zotërinj?

Po! Akuzoj!

Dhe kjo akuzë në emër të së vërtetës është e ashpër.

E përkëdhelura e Evropës ka ardhur koha, në se do paqen dhe qetësinë në rajon, të shohë hallet e saj dhe të mos mprehë thonjtë për të gërvishur trupin e të tjerëve.

Jemi në Shqiptarët, që me djersën tonë po e bëjmë Shqipërinë. Vërtet pak ngadalë se jemi të varfër, por me hapa të ngurtë, për të mos u kthyer mbrapa.

Askush veç nesh, nuk ia mbyll dot plagët asaj, se nuk shërohen ato plagë pa melhem të shpirtit tonë.

Koha po hedh në skenë zgjidhje të reja dhe shqiptarët do dinë të orientohen drejt për të lulëzuar vendin e tyre, jetën e tyre

Vetë koha do ta tregojë.